

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1315/2014 të datës 08.08.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit, me datë 23.11.2015, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. S. nga i ati F. dhe e ëma S. e lindur B., i lindur më datë “data e lindjes .. “ në Prizren ku edhe tani jeton rruga “.....” ../. , ka të kryer shkollën e mesme, tv mekanik, i pa martuar, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 12.02.2014 rreth orës 21:25 minuta, në Prizren rrugën “.....” në shtëpinë e tyre familjare, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës – bashkëshortes E. P. , që rezulton me dobësim të përkohshëm të një pjese të trupit në atë mënyrë që pas një konflikti në mesë tyre lidhur me një mesazh që kishte pranuar i akuzuari në telefonin mobil, e dëmtuara kishte kërkuar që të lexonte, por i njëjti nuk e lejon që të lexoj pas kësaj fizikisht e sulmon dhe pastaj e kap për flokë së cilës i shkakton lëndime të lehta trupore dhe ngacmim psiçik të disfavorshëm me ambientin rrethues.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 46, 73 dhe nenit 188 par.1 nën par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 8 (tetë) ditë dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

E dëmtuara E. (A.) P. nga fshati Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1315/2014 të datës 08.08.2014, ushtruar kundër të akzuarit A. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I njëjti nuk e kundërshtoj provat dhe e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 12.02.2014 rreth orës 21:25 minuta, në Prizren saktësisht në shtëpinë e tyre, për shkak të mosmarrëveshjes në mes të bashkëshortëve rreth një mesazhi që ishte në telefonin e tij, i akuzuari A. S. fillimisht fjaloset dhe pastaj e sulmon fizikisht bashkëshorten e tij – të dëmtuarën E. P. duke e kap për flokë së cilës i shkakton lëndime të lehta trupore dhe ngacim psikik të disfavorshëm me ambientin rrethues. Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza me ç'rast i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor është njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe se në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit duke

menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjesisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat me lart është vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1218/2014 të datës 23.11.2015

Procesmbjatesja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.